



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË
KRYETARI I KËSHILLIT**

Nr. 1286 Prot

Gjirokastër më 04 : 05 : 2023

Lënda: Procesverbal i mbledhjes së dates 28.04. 2023.

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së datës 28.04. 2023

PROCESVERBAL

I mbajtur sot në **datë 28.04.2023** në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastër. Mbledhja po zhvillohet në sallën e hotel “Çajupit”. Mbledhja fillon në orën 12:25 min.

Marrin pjesë në mbledhje 16 anëtarë

Mungojnë në mbledhje; Kallajnxhi, Veizaj, Isaraj, Hilaj, Feruni, Xheko, Qeli, Nebiaj, Çamani, Llogo, Kore, Arapaj, Balloma, Gjini.

Hapet mbledhja nga Z. Hasani. Është kuorumi për fillimin e mbledhjes.

Z. Hasani mban fjalën e tij përshëndetëse për Këshillin Bashkiak dhe përfaqësuesit e ekzekutivit për punën 4-vjeçare në drejtim të Këshillit Bashkiak duke falënderuar për bashkëpunimin këshilltarët, ekzekutivin dhe stafin mbështetës.

Z. Hasani paraqet rendin e ditës së bashku me pikën shtesë të propozuar nga ekzekutivi:

P/Vendim për vendosjen në Shtëpinë e të moshuarve të Z. Gjedheon Mino”

Miratohet rendi i ditës së bashku me pikën shtesë me 16 vota pro.

1. Miratim i procesverbalit të mbledhjes së dates 31.03.2023.
2. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin **01-30.04. 2023**”.
3. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **01-30. 03.2023**”.
4. P/Vendim “Për miratimin e buxhetit faktik 2022”.
5. P/Vendim “Për një shtesë në VKB Nr .100, datë 16.12.2022 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe buxhetit të vitit 2023”.
6. Të ndryshme

Miratohet me 18 vota pro procesverbali i mbledhjes së datës 31.03.2023

Hidhen në votë dhe miratohen pikat 2 dhe 3 të rendit të ditës dhe miratohen me 19 vota pro. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin **01-30.04. 2023**”.

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **01-30. 04.2023**”.

Z.Hasani paraqet para këshilltarëve pikën 4 të rendit të ditës.

Flet në emër të Komisionit të Ekonomisë znj. Lindita Rova.

Buxheti faktik është një analizë përfundimtarë e ekzekutivit për zërat që janë realizuar gjatë zbatimit të buxhetit, zërat më pak të realizuar dhe arsyt e realizimeve dhe mosrealizimeve. Mund të kërkojmë llogari për planifikimin dhe ekzekutivi duhet të nxjerrë arsyt e mosrealizimeve dhe problemet që janë hasur gjatë zbatimit të buxhetit.

Syngjeroj ekzekutivit që për çdo problem të hasur në planifikim dhe zbatim të nxirren përgjegjësitë individuale dhe në vitin 2023 të mos vini me mosrealizime dhe të jeni më të përgatitur për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Z.Petrit Brahim:Shoh emergjencat civile me 0% dhe më duket e habitshme , gjithashtu edhe me rrugët rurale , dua një informacion të shkurtër për zërat . Ky material ka nevojë për debat dhe analizë dhe të nxirren edhe përgjegjësitë.

Znj.Artiste Koko:Referuar tre zërave me realizim të ulët ka të bëjë me tre projekte të bashkisë të cilat kanë filluar në tremujorin e fundit dhe do të vazhdojnë në vitin 2023.

Për Emergjencat civile rruga e Zhulatis ka filluar në muajin tetor 2022, sepse kemi qenë në pritje për të fituar projektin dhe pasi kemi marrë përgjigje negative , kemi vazhduar me procedurat të cilat për shkak të mosrealizimit të afateve janë transferuar në buxhetin e vitit 2023.gjithashtu edhe investimi për Pallatin e Sportit ka ardhur në fund të vitit 2022 , dhe ka kaluar si investim në vitin 2023.

Z. Hasani hedh në votë dhe miratohet me 16 vota pro P/Vendim për miratimin e Buxhetit Faktik 2022”.

Kalohet te pika 5 e rendit të ditës: P/Vendim “Për një shtesë në VKB Nr .100, datë 16.12.2022 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe buxhetit të vitit 2023”.

Sqaron nga ekzekutivi znj. Jorida Muho.Këto dy projekte janë miratuar, por jemi në fazën kur kanë kaluar lekët në llogarinë e bashkisë dhe duhet vazhduar me zbatimin e projekteve.Për këtë duhet më parë miratimi në Këshill.

Hidhet në votë dhe miratohet me 16 vota pro pika 5. P/Vendim “Për një shtesë në VKB Nr .100, datë 16.12.2022 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe buxhetit të vitit 2023”.

Mbyllet mbledhja nga Z. Hasani.

Sekretar
Etleva Yzo

